



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 236, datë 14.4.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË GODINËS SË KOPSHTIT PUBLIK DHE GODINËS
SË BASHKISË VORË, BASHKIA VORË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË
VORË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 707 302 333 (shtatëqind e shtatë milionë e treqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të godinës së kopshtit publik dhe godinës së Bashkisë Vorë, Bashkia Vorë, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Rindërtimi i godinës së kopshtit publik, Bashkia Vorë, në masën 88 433 787 (tetëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH;
 - b) Rindërtimi i godinës së Bashkisë Vorë, në masën 618 868 546 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë lekë) lekë pa TVSH.
2. Bashkisë Vorë, për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 141 460 466 (njëqind e dyzet e një milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e

gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Për rindërtimin e godinës së kopshtit publik, Bashkia Vorë, në vlerën 17 686 757 (shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH;
 - b) Për rindërtimin e godinës së Bashkisë Vorë, Bashkia Vorë, në vlerën 123 773 709 (njëqind e njëzet e tre milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntë) lekë pa TVSH.
3. Caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese për rindërtimin e godinës së kopshtit publik dhe të godinës së Bashkisë Vorë, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.
 4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACË

**MINISTRI I SHITETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ